



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS  
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE

Nr. 500/Prot.  
2

Patos, më 19/02/2024



PROJEKT-VENDIM

Nr. 18, datë 19/02/2024

RAPORTI PËR VLERËSIMIN DHE PARASHIKIMIN AFATMESËM TË TË  
ARDHURAVE TË VETA

BASHKIA PATOS PËR VITET 2025-2027

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

#### Përmbajtja

1. Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave
  - Të ardhurat nga Taksat Vendore
  - Të ardhurat nga Taksat e Ndara
  - Të ardhurat nga Tarifat Vendore
  - Të ardhura të tjera.
2. Metodologjia e përdorur për parashikimet afatmesme të të ardhurave.
3. Analiza e efekteve të politikave të reja fiskale ose të ndryshimit të atyre ekzistuese.
4. Analiza e risqeve dhe masat për përballimin e tyre.

#### 1. Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave.

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave , me përjashtim të transfertës nga burimet qendrore, këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore.”

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Patos, e cila përcakton llojet e taksave dhe tarifave vendoren , bazën e taksueshme, nivelin e tyre, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, lehtësirat dhe përjashtimet, strukturat përgjigjese për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimor.

Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Në hartimin e paketës fiskale të Bashkisë Patos janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh dhe të vogël, banorë të njësive administrative , përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe këshilltarë.

Diskutimet publike janë organizuar në çdo njësi administrative dhe në qytet, për ndryshimet janë bërë takime konsultative gjithëpërfshirëse. Gjatë këtyre takimeve me bashkëqytetarët, banorë,përfaqësues të grupeve të interesit, është diskutuar dhe janë bërë propozime për përmirësim.

Paketa fiskale e Bashkisë Patos, pasqyron disa politika të rëndësishme lehtësuese dhe përjashtuese sipas kopetencave ligjore, si më poshtë:

#### - Politikat lehtësuese në taksa.

- Përjashtim nga pagesa e taksës së ndërtesës për pensionistët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.
- Ulje e nivelit maksimal të lejuar prej 20 % nga referenca ligjore për taksapaguesit të cilët do të paguajnë taksën e tokës bujqësore brenda muajt gusht.

#### - Politika lehtësuese në tarifa.

- Përjashtim nga pagesa e Tarifës së Pastrimit/Ndriçimit/Gjelbërimit për bizneset e reja kur nr. i të punësuarve do të jetë mbi 10 persona.
- Përjashtim nga pagesa e Tarifës së Pastrimit/Ndriçimit/Gjelbërimit për fermerët e paisur me NIPT.
- Përjashtim nga pagesa e Tarifës së Pastrimit/Shërbimit Komunitar për familjet që kanë persona me PAK , e veteranëve të luftës, e ndihmës ekonomike.

- Përrjashtim nga pagesa e Tarifës së Pastrimit/Shërbimit Komunitar për familjet e të persekutuarve politikë.
- Përrjashtim nga pagesa e Tarifës së Pastrimit/Shërbimit Komunitar për familjet e pensionistëve të vetmuar.

Sipas ligjit 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35/2 bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksave dhe tarifave , mënyrën e llogaritjes së tyre, si dhe mbledhjen e administrimin e tyre brenda kufijve e sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.

Llogaritja e të ardhurave mbështetet në :

1. Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;
2. Ligjin nr. 9920, datë 26.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Patos nr.71. datë 30.11.2023 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave për vitin 2024”
4. Ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

#### **Ecuria e të ardhurave dhe parashikimi për tre vitet të tjera buxhetore**

Treguesit janë paraqitur për dy vite para vitit buxhetor, vitin buxhetor, parashikimi për tre vitet e ardhshme.

#### **Të ardhurat nga burimet lokale dhe burimet qëndrore**

**Tabela 1**

në 000/lekë

	<i>BURIMET E FINANCIMIT</i>	Faktii vitit 2022	Fakti vitit 2023	Parashikimi për vitin 2024	Parashikimi për vitin 2025	Parashikimi për vitin 2026	Parashikimi për vitin 2027
1	<i>Të ardhura të trashguara nga viti i kaluar</i>	148,556	149,883	109,035	0	0	0
2	<i>Të ardhurat lokale</i>	203,313	240,198	297,432	302,832	308,232	308,232
3	<i>Transferta Specifike</i>	97,605	101,520	114,515	114,515	114,515	114,515
4	<i>Transferta e pakushtëzuar</i>	196,097	221,647	255,990	255,990	255,990	255,990
5	<i>Transferta Specifike të trashguara</i>	33,473	28,883	51,975	0	0	0
	<b><i>Të ardhurat gjithësej</i></b>	<b>679,044</b>	<b>742,131</b>	<b>828,947</b>	<b>673,337</b>	<b>678,737</b>	<b>678,232</b>



## Të ardhurat nga burimet e veta vendore sipas llojit

Tabela 2

në 000/ lekë

	<i>BURIMET E FINANCIMIT</i>	Fakti vitit 2022	Fakti vitit 2023	I pritshmi i vitit 2024	Parashikim për vitin 2025	Parashikimi për vitin 2026	Parashikimi për vitin 2027
1	Të ardhura nga taksat vendore	58,962	59,490	90,710	90,910	91,110	91,110
2	Të ardhura nga taksat e ndara	103,635	83,958	98,834	103,834	108,834	108,834
3	Të ardhura nga tarifa	36,608	79,595	101,578	101,778	101,978	101,978
4	Të ardhura të tjera	4,108	17,155	6,310	6,310	6,310	6,310
	<b>Të ardhurat e veta totale</b>	<b>203,313</b>	<b>240,198</b>	<b>297,432</b>	<b>302,832</b>	<b>308,232</b>	<b>308,232</b>

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhura nga taksat, të ardhura nga taksat e ndara, të ardhura nga tarifatat, të ardhurat të tjera. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat nga taksat në masën 64 % për vitin 2025, 65 % për vitin 2026 dhe 65 % për vitin 2027.

Tarifatat përbëjnë 34 % të të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2025, 33 %, për vitin 2026 dhe 33 % për vitin 2027. Të ardhurat e tjera kemi një mesatare me 2%.

## 2. Metodologjia e përdorur për parashikimin afatmesëm të të ardhurave 2025 - 2027

Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë Patos është mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapacitetit të taksave e tarifave vendore, informacion i përfituar nga programi i taksave vendore, në ecurinë e realizimit të tyre në dy vite para të vitit aktual si dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim, duke u mbështetur në aktet ligjore për to. Këto parashikime mbështeten në llogaritjet e përgjithshme që janë të lidhura ngushtë me masat, që pritet të ndërmerren nga administrata tatimore në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë por dhe jashtë saj, për realizimin e parashikimeve të pretenduara të të ardhurave.

Parashikimi i të ardhurave për këtë periudhë afatmesme reflekton dhe ndryshimet në paketën fiskale si dhe parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve;

Në këtë parashikim janë marrë në konsideratë:

- Rritja të ardhurave nëpërmjet rritjes së bazës së taksapaguesve dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja);
- Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet;
- Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe analiza një për një e çdo takse dhe tarife, për faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimit;

## Të ardhurat nga taksat vendore

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të taksave dhe tarifave vendore, mbledhjes dhe administrimit të tyre.

Paketa fiskale e Bashkisë Patos për këtë kategori është e hartuar dhe e ndryshuar edhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh dhe të vogël, banorëve të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe këshilltarë.

Për vitet 2025-2027 parashikohet që të ardhurat nga taksat të përbëjnë rreth 65 % të të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë.

**Tabela 3**

në 000/ lekë

Emertimi i të ardhurave Tatimore	Fakti vitit 2022	Fakti vitit 2023	I prishmi vitit 2024	Parashikimi për vitin 2025	Parashikimi për vitin 2026	Parashikimi për vitin 2027
<b>Të ardhurat nga taksat</b>	<b>58,962</b>	<b>59,490</b>	<b>90,710</b>	<b>90,910</b>	<b>91,110</b>	<b>91,110</b>
Taksa mbi ndërtesën	9,870	11,218	21,850	22,050	22,250	22,250
Taksa mbi tokën bujqësore	8,474	9,082	21,420	21,420	21,420	21,420
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	1,772	1,145	7,000	7,000	7,000	7,000
Taksa e tabelës	882	635	650	650	650	650
Taksa mbi truallin	37,397	37,010	38,500	38,500	38,500	38,500
Taksë tregu	567	400	1,290	1,290	1,290	1,290

### **Analiza e parashikimit të të ardhurave për secilën taksë**

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

### **Të ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme**

- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin



## **Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat**

Parashikimi për vitet 2025-2027 bazohet të zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- saktësimin dhe vlerësimin të drejtë të sipërfaqeve
- rritjes së efikasitetit me implementimin e programeve të kompjuterizuar
- ndarjes në këste të pagesave

Planifikimi i të ardhurave është bërë duke u bazuar tek të dhënat sipas kontratës me OSHE, si dhe duke iu referuar tendencës në rritje të kapacitetit të realizimit të të ardhurave ndër vite. Të ardhurat nga taksa për ndërtesat për vitin 2025 parashikohen në vlerën 22,050,000 lekë, për vitin 2026 në vlerën 22,250,000 lekë dhe për vitin 2027 në vlerën 22,250,000 lekë me një rritje të lehtë mesatare prej 1 %.

## **Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore**

Baza e taksës është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose në përdorim të taksapaguesit.

Duke u krahasuar me referencën ligjore, taksa e çdo kategorie e tokës bujqësore ka një lehtësim që shkon në maksimumin e lejuar ligjor prej 20 %.

Planifikimi i të ardhurave bazohet mbi kapacitetin aktual fiskal të njësisve administrative, mbi parashikimin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve nëpërmjet saktësimin të sipërfaqeve reale dhe kategorizimit të saktë dhe aktual të tokës bujqësore, si dhe duke iu referuar tendencës në rritje të kapacitetit të realizimit të të ardhurave ndër vite. Të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore për vitin 2025 parashikohen në vlerën 21,420,000 Lekë, për vitin 2026 me vlerë 21,420,000 lekë, për vitin 2027 me vlerë 21,420,000 lekë.

## **Të ardhura nga taksa mbi truallin**

Me "Truall" kuptohet një sipërfaqe toke, jo tokë bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, të miratuar për të ndërtuar mbi të. Baza e taksës është sipërfaqja në metër katror.

Planifikimi i të ardhurave është bërë duke u bazuar në sipërfaqet aktuale të banesave dhe ndërtesave të tjera, dhe mbi parashikimin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve nëpërmjet saktësimin të sipërfaqeve. Të ardhurat nga taksa e truallit për vitet 2025-2026-2027 parashikohen në vlerën 38,500,000 lekë.

## **Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë**

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja administrohet nga Bashkia Patos. Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja përcaktohet në kufijtë 4-8% e çmimit të shitjes për ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik.

Bazuar në Ligjin Nr. 9482 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa

leje”, taksa për ndërtesat në proces legalizimi llogaritet 0,5% e vlerës së investimit.

Parashikimi për taksën e ndikimit në infrastrukturë bazohet mbi parashikimin e lejeve për ndërtimet e reja dhe shlyerjen e detyrimeve për objektet në proces legalizimi .

Të ardhurat nga kjo taksë vitin 2025 parashikohen në vlerën 7,000,000 lekë, për vitin 2026 me vlerë 7,000,000 lekë, për vitin 2027 me vlerë 7,000,000 lekë.

#### Të ardhura nga taksa e tabelës

Bazuar në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndyshuar taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:

Tabela për qëllime identifikimi, të cilat nëse janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitetin biznesi. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m<sup>2</sup> nuk taksohen. Tabela për qëllime reklamimi, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike.

Tabela për qëllime ekspozimi, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2025 parashikohen në vlerën 650,000 lekë, për vitin 2026 me vlerë 650,000 lekë, për vitin 2027 me vlerë 650,000 lekë.

#### Të ardhura nga taksat e ndara

Bazuar në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar përcaktohet administrimi i taksës kombëtare ku pas arkëtimit nga institucionet shtetërore në rolin e agjentëve tatimorë, një pjesë e këtyre të ardhurave transferohen në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore sipas përkatësisë nga burojnë.

Tabela 4

në 000/lekë

Emërtimi i të ardhurave Tatimore	Fakti vitit 2022	Fakti vitit 2023	I pritshmi vitit 2024	Parashikimi për vitin 2025	Parashikimi për vitin 2026	Parashikimi për vitin 2027
<b>Të ardhurat nga taksat e ndara</b>	<b>103,635</b>	<b>83,958</b>	<b>98,834</b>	<b>103,834</b>	<b>108,834</b>	<b>108,834</b>
Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura	17,596	18,100	17,000	19,000	21,000	21,000
Taksa e Rentës minerare	78,114	55,638	75,434	78,434	81,434	81,434
Tatimi mbi të ardhurat personale (TAP)	7,805	9,940	6,000	6,000	6,000	6,000
Tatimi thjeshtuar mbi fitimin për biznesin	120	253	0	0	0	0
Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë	0	27	400	400	400	400



## **Të ardhura nga Taksa e rregjistrimit të mjeteve të përdorura**

Referuar pikës 3, të nenit 4 të ligjit nr. 9975, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimor, bazuar në numrin e mjeteve të rregjistruara, 25% e të ardhurave nga kjo taksë kalon për llogari të Bashkinë Patos.

Planifikimi bëhet nga agjenti tatimor referuar numrit të automjeteve si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara rereferuar të dhënave për nivelet e arkëtimeve. Të ardhurat nga kjo taksë vitin 2025 parashikohen në vlerën 19,000,000 lekë, për vitin 2026 në vlerën 21,000,000 lekë dhe për vitin 2027 parashikojmë në vlerën 21,000,000 lekë, mesatarisht kemi njëritje me 12%.

## **Të ardhura nga Taksa e Rentës minerare**

Bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar, baza e taksës së rentës minerare llogaritet mbi burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Personi fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit.

Planifikimi i të ardhurave i referohet realizimit të të ardhurave ndër vite. Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2025 parashikohen në vlerën 78,434,000 lekë, për vitin 2026 në vlerën 81,434,000 lekë dhe në vitin 2027 në vlerën 81,434,000 lekë, njëritje mesatare 4%.

## **Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale (TAP)**

Në zbatim të ligjit nr. 68/2017 “Për financat vetëqeverisjes vendore” neni 25 pika 2 gërma ç, pushteti vendor përfiton 2 % e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale. Përllogaritja dhe ndarja për taksën bëhet nga Ministria e financave.

Të ardhurat nga kjo taksë për vitet 2025, 2026 dhe 2027 parashikohen në vlerën 6,000,000 lekë.

## **Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël**

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero). E ardhura nga kjo taksë si rezultat i ndryshimeve ligjore për vitet në vijim është zero.

## **Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme**

Kjo taksë administrohet nga Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Taksa paguhet para kryerjes së regjistrimit, nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat në rolin e agjentit tatimor përfitojnë 3% të



shumës së arkëtuar, ndërsa diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Patos jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Parashikimi i të ardhurave nga kjo taksë bëhet duke u bazuar në të ardhurat e viteve të kaluara.

Të ardhurat nga kjo taksë për vitet 2025,2026 dhe 2027 parashikohen në vlerën 400,000 lekë.

## Të ardhurat nga Tarifat Vendore

Referuar ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifatat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore; dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj. Gjithashtu bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive, dhe të tjera të përcaktuara me ligj.

Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikën dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.

Paketa fiskale e Bashkisë Patos, pasqyron disa politika të rëndësishme lehtësuese dhe përjashtuese sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

- Përjashtim nga pagesa e Tarifës së Pastrimit/Ndriçimit/Gjelbërimit për bizneset e reja kur nr. i të punësuarve do të jetë mbi 10 persona.
- Përjashtim nga pagesa e Tarifës së Pastrimit/Ndriçimit/Gjelbërimit për fermerët e paisur me NIPT.
- Përjashtim nga pagesa e Tarifës së Pastrimit/Shërbimit Komunitar për familjet që kanë persona me PAK, e veteranëve të luftës, e ndihmës ekonomike.
- Përjashtim nga pagesa e Tarifës së Pastrimit/Shërbimit Komunitar për familjet e të persekutuarve politikë.
- Përjashtim nga pagesa e Tarifës së Pastrimit/Shërbimit Komunitar për familjet e pensionistëve të vetmuar.

**Tabela 5**

në/000/lekë

Emërtimi i të ardhurave nga tarifatat	Fakti vitit 2022	Fakti vitit 2023	I pritëshmi vitit 2024	Parashikimi për vitin 2025	Parashikimi për vitin 2026	Parashikimi për vitin 2027
<b>Të ardhurat nga tarifatat</b>	<b>36,608</b>	<b>79,595</b>	<b>101,578</b>	<b>101,778</b>	<b>101,978</b>	<b>101,978</b>
Tarifa për pastrimin	18,720	25,252	42,031	42,231	42,431	42,431
Tarifa e shërbimit komunitar	439	1,142	5,026	5,026	5,026	5,026
Tarifë për hapësirat publike	30	30	250	250	250	250
Tarifë për ndriçim rrugor	1,240	1,505	1,800	1,800	1,800	1,800
Tarifë gjelbërimi	1,384	1,393	1,800	1,800	1,800	1,800
Tarifë për reklamë	0	0	507	507	507	507

Tarife për parkim	687	602	921	921	921	921
Tarife për shërbime të tjera administrative	1,171	613	1,149	1,149	1,149	1,149
Tarifë për dhënie leje licënsa dhe autorizime	1,204	1,284	3,179	3,179	3,179	3,179
Tarifë ndotje mjedisi	11,073	46,968	44,035	44,035	44,035	44,035
Tarifa për mirmbajtje vaditje kullim	660	648	880	880	880	880
Të tjera jo tatimore	0	158	0	0	0	0

Për vitin 2025-2027 të ardhurat e parashikuara nga tarifat përbëjnë mesatarisht 33 % të të ardhurave nga burimet e vetavdore.

Pjesë e rëndësishme në këtë kategori të të ardhurave nga tarifat janë të ardhurat nga tarifat për ofrimin e shërbimeve publike, si pastrimi e largimi i mbetjeve 47 %, tarifa për ndotje mjedisi në zona të veçanta 43 %, gjelbërim& ndriçimi 4 %, të cilat së bashku zënë 94 % të totalit të të ardhurave nga tarifat vendore. Në teritorin e Bashkisë Patos aplikohen edhe tarifa të tjera si tarifa për zënie të hapsirës publike , tarifa për shërbimet administrative, tarifë parkimi, tarifë për dhënie leje, licënsa dhe autorizime, të gjitha sëbashku zënë 6 % të të ardhurave nga tarifat.

## Të ardhura te tjera

Tabela 6

në/000/lekë

Emertimi i të ardhurave të tjera	Fakti vitit 2022	Fakti vitit 2023	1 pritëshmi vitit 2024	Parashikimi per vitin 2025	Parashikimi per vitin 2026	Parashikimi per vitin 2027
<b>Të ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qera</b>	<b>2,061</b>	<b>3,509</b>	<b>3,010</b>	<b>3,010</b>	<b>3,010</b>	<b>3,010</b>
<i>Qera troje (toke)</i>	268	1,623	1,300	1,300	1,300	1,300
<i>Qera nga ndërtesat</i>	1,793	1,886	1,710	1,710	1,710	1,710
<b>Të ardhura nga pagesat</b>	<b>2,047</b>	<b>13,646</b>	<b>3,300</b>	<b>3,300</b>	<b>3,300</b>	<b>3,300</b>
<i>Dhurata dhe sponsorizime te ndryshme</i>	0	11,516	0	0	0	0
<i>Te ardhurat nga gjobat</i>	336	205	500	500	500	500
<i>Te ardhura nga pagesat per kopeshte dhe çerdhe</i>	1,711	1,925	2,800	2,800	2,800	2,800
<b>Shuma totale</b>	<b>41,08</b>	<b>17,155</b>	<b>6,310</b>	<b>6,310</b>	<b>6,310</b>	<b>6,310</b>

## Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë

Te ky zë parashikohen të ardhurat nga qira të bazuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar. Pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i lirë, i lirë funksional (jo nënndërtesë), makineritë e pajisjet dhe linjate prodhimit. Këto të ardhura zen një % të vogël në buxhet pasi jemi mbeshtetur në faktin e pronave që kemi dhëne me qera.



## **Të ardhurat nga kundrvajtje administrative (nga gjobat)**

Gjobat bazohen në ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”: Bazuar në nenin 6.b, ”Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative parashikohen me akte të këshillit bashkiak, për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre në njësitë territoriale përkatëse, ku, sipas ligjit, ushtrojnë funksionete veta”.

Bazuar në nenin 10, “Masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative. Masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë. Në rastet kur kundërvajtjet administrative parashikohen në aktet e miratuara nga këshilli bashkiak, masa e dënimit përcaktohet në këto akte.

Ky zë parashikon të ardhurat nga gjoba për mosshlyerje detyrimi në afate ligjore nga bizneset, gjoba nga kontrolle dhe inspektive tatimore, gjoba për kundrvajtje administrative që mund të vendosen nga Policia Bashkiake, nga Inspektorati Ndërtimit Vendor etj.

## **Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve**

Sipas përcaktimeve ligjore janë të ardhura që përfshihen në zërin të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve. Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë.

## **Të ardhura nga sponsorizimet**

Planifikimi i të ardhurave bazohet mbi marrëveshjet për sponsorizime dhe donacione. Të ardhurat nga sponsorizime dhe donacione për vitin 2025-2027 nuk kemi parashikuar pasi nuk ka marrëveshje.

## **Të ardhurat nga pagesat**

Të ardhurat nga pagesat për kopësht dhe çerdhe. Për parashikimin e të ardhurave në këtë zë jemi mbështetur te nr. i fëmijëve që frekuentojnë kopësht dhe çerdhe, si dhe kuarën ditore të tyre e cila ka dalë sipas analizës së kostos.

Tabela mbi parashikimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore si dhe burimet e tjera që do të përbëjnë buxhetin afatmesëm të të ardhurave në Bashkinë Patos:



**Tabela 7 Të ardhurat totale Bashkia Patos për PBA 2025-2027**

në/000/lekë

Emërtimi i të ardhurave Tatimore	Fakti vitit 2022	Fakti vitit 2023	I pritëshmi për vitin 2024	Parashikimi për vitin 2025	Parashikimi për vitin 2026	Parashikimi për vitin 2027
<b>Të ardhurat nga taksat</b>	<b>162,597</b>	<b>143,448</b>	<b>189,544</b>	<b>194,744</b>	<b>199,944</b>	<b>199,944</b>
Taksa mbi Ndërtesat	9,870	11,218	21,850	22,050	22,250	22,250
Taksa mbi tokën bujqësore	8,474	9,082	21,420	21,420	21,420	21,420
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	1,772	1,145	7,000	7,000	7,000	7,000
Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë për pasuri të pa luajtshme	0	27	400	400	400	400
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	17,596	18,100	17,000	19,000	21,000	21,000
Taksa e tabelës	882	635	650	650	650	650
Taksa e rentës minerare	78,114	55,638	75,434	78,434	81,434	81,434
Tatim mbi të ardhurat personale TAP	7,805	9,940	6,000	6,000	6,000	6,000
Taksa mbi truallin	37,397	37,010	38,500	38,500	38,500	38,500
Tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogël	120	253	0	0	0	0
Taksë tregu	567	400	1,290	1,290	1,290	1,290
<b>Të ardhurat nga tarifat</b>	<b>36,608</b>	<b>79,595</b>	<b>101,578</b>	<b>101,778</b>	<b>101,978</b>	<b>101,978</b>
Tarifa për pastrimin	18,720	25,252	42,031	42,231	42,431	42,431
Tarifa e shërbimit komunitar	439	1,143	5,026	5,026	5,026	5,026
Tarifë për hapsirat publike	30	30	250	250	250	250
Tarifë për ndriçim rrugor	1,240	1,505	1,800	1,800	1,800	1,800
Tarife gjelbërimi	1,384	1,393	1,800	1,800	1,800	1,800
Tarife për reklamë	0	0	507	507	507	507
Tarife për parkim	687	602	921	921	921	921
Tarifë për shërbime të tjera administrative	1,171	613	1,149	1,149	1,149	1,149
Tarife për dhënie leje liçensa dhe autorizime	1,204	1,284	3,179	3,179	3,179	3,179
Tarifë ndotje mjedisi	11,073	46,968	44,035	44,035	44,035	44,035
Tarifa për mirmbajtje vaditje kullim	660	648	880	880	880	880
Të tjera jo tatimore	0	157	0	0	0	0
<b>Të ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qera</b>	<b>2,061</b>	<b>3,509</b>	<b>3,010</b>	<b>3,010</b>	<b>3,010</b>	<b>3,010</b>
Qera troje (toke)	268	1,623	1,300	1,300	1,300	1,300
Qera nga ndërtesat	1,793	1,886	1,710	1,710	1,710	1,710
<b>Të ardhura të tjera</b>	<b>2,047</b>	<b>13,646</b>	<b>3,300</b>	<b>3,300</b>	<b>3,300</b>	<b>3,300</b>
Dhurata dhe sponsorizime të ndryshme	0	11,516	0	0	0	0
Të ardhurat nga gjobat	336	205	500	500	500	500
Të ardhura nga pagesat për kopështe dhe çerdhe	1,711	1,925	2,800	2,800	2,800	2,800
<b>Të Ardhurat e Veta Totale</b>	<b>203,313</b>	<b>240,198</b>	<b>297,432</b>	<b>302,832</b>	<b>308,232</b>	<b>308,232</b>

## Të ardhurat e veta fluide (cash flow) në bazë mujore

Referuar arkëtimeve të viteve të kaluara, nivelet më të larta të arkëtimit janë bërë pas muajt gusht si 8/mujor si efekt i njoftimeve të vazhdueshme dhe ndjekjes së masave administrative shtrënguese ligjore.

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Të Ardhurat	2 %	1 %	11%	4 %	4 %	4 %	8 %	10 %	8 %	10 %	18 %	4 %

## Analiza e risqeve dhe masat për përballimin e tyre

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin. Ligji përmban koncepte dhe përgjegjësi të reja për menaxhimin e riskut në institucionet publike.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen.

Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

E rëndësishme është që risku të menaxhohet në mënyrë efektive.

Strategjia e riskut përkufizohet si qasja e njësisë për menaxhimin e riskut e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë publike dhe më tej. Ajo përcakton mënyrën se si sillet njësia ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat përgjegjëse për menaxhimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve. Për risqet që janë cilësuar më të lartat (më kritiket), duhet të hartohet një plan afat-gjatë veprimi.

Për realizimin e të ardhurave të veta vendore, njëkohësisht duke ruajtur tendencën për përmirësimin e politikave dhe strategjive incentivuese e zhvilluese të ekonomisë lokale, është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut duke kaluar në këto etapa:

1. Identifikimi i objektivave;
2. Identifikimi i risqeve të jashtme dhe të brendshme;
3. Analiza dhe vlerësimi i çdo risku (sipas probabilitetit dhe impaktit);
4. Marrja e masave të metejshme, për pakësimin apo reduktimin e riskut;
5. Paraqitja e të gjithë konkluzioneve të arritura;
6. Krijimi i hartës së riskut, grupimi në bazë të impaktit dhe probabilitetit të ndodhjes së tyre, duke treguar në këtë mënyrë ato fusha të veprimtarisë së njësisë, ndaj të cilave duhet të tregohet vëmendje e veçantë;
7. Monitorimi dhe raportimi;
8. Hartimi i planit të veprimit për zbatimin e strategjisë.



Objektivat janë planifikimi buxhetor, llogaritja, analizimi i burimeve të të ardhurave të veta, ndjekja e politikave dhe strategjive sensibilizuese, mbështetese dhe zhvilluese për krijimin e të ardhurave, zbutjes së informalitetit, rritjes së konkurrencës së ndershme, si dhe administrimi i marrëdhënieve me taksapaguesit dhe shërbimi ndaj tyre.

### GRUPI PËR MENAXHIM STRATEGJIK



Sokol Meta



Shkëlqim Beqiri

Arben Semanjaku



Mimosa Shtëmbari

Juela Shpata

Astrit Murati

Boreta Murati

Erion Hatia

Orges Golloshi

Elda Goxhaj

Eneo Xhaferi

Alket Halimi

Endri Çako

Armando Gushi

Florian Kita

Blerina Laçi

Barie Goxhaj

Nurke Hazizaj

Lindita Pepa

Arben Shpërdheja

Adm. Njësia Administrative Zharrëz

Adm. Njësia Administrative Ruzhdie

Riza Hoxha



Agim Mesutaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE**

Nr. 500 Prot.  
13

Patos, më 19/02 /2024

**RELACION**

**MBI**

**PARASHIKIMIN AFATMESËM TË TË ARDHURAVE PËR VITET 2025-2027**

Misioni i këtij buxheti ashtu si dhe gjithë buxhetet e hartuar edhe më parë nga Bashkia Patos është të jetë gjithpërfshirës, i paanshëm, perceptues, transparent, por mbi të gjitha është të jetë i ligjshëm.

Në këtë kuadër hartimi i parashikimit afatmesëm të të ardhurave është i përgatitur në mbështetje të ligjeve:

1. Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar.
2. Ligjin nr. 9920, datë 26.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Patos nr.71. datë 30.11.2023 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendorë për vitin 2024”.
4. Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Hartimi i PBA-së përbën një proces shumë të rëndësishëm për Bashkinë e Patosit, pasi ky dokument siguron mekanizmat e nevojshme përmes të cilave, objektivat prioritare të identifikuar në Programin e Bashkisë së Patosit dhe në dokumentat e tjerë strategjike, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

**Objektivat e Programit Buxhetor Afatmesëm për pjesën e të ardhurave janë:**

1. Një kuadër i qëndrueshëm planifikimi afatmesëm, brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore,
2. Forcimi i lidhjes mes programeve politike të Bashkisë dhe alokimit të burimeve.

## **Qëllimet e Programit Buxhetor Afatmesëm:**

1. Zgjerimi i vizionit të procesit të buxhetimit duke synuar të planifikohen në një periudhë afatmesme (3-vjeçare);
2. Një parashikim më i mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për një periudhë tre vjeçar.
3. Forcimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal.

## **Roli i Programit Buxhetor Afatmesëm:**

Programi Buxhetor Afatmesëm është një instrument i cili synon integrimin e programit të bashkisë, në politika vendore dhe konkretizimin e tyre në plane shpenzimesh.

Ky dokument synon të informojë Këshillin e Bashkisë lidhur me planet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave të Bashkisë Patos.

Ky dokument synon t'i japë mundësinë Këshillit Bashkiak, si organ vendimmarrës, për të zhvilluar një kuadër të qartë burimesh në periudhë afatmesme që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale të Bashkisë.

Ky program i shërben gjithashtu Njësive Shpenzuese pasi mundëson përcaktimin në mënyrë të qartë prej tyre të politikave dhe programeve për çdo aktivitet, për të përcaktuar kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të alokohen tek programet prioritare në periudhën afatmesme.

Ky proces synon parashikimin e të ardhurave, si një mjet që përkthen qëllimet dhe objektivat strategjike në synime financiare, duke prezantuar politikat fiskale dhe financiare të Bashkisë Patos.

Bashkëlidhur gjeni parashikimin afatmesëm të të ardhurave i ndërtuar me tabela.

Baza e përlllogaritjeve janë të gjitha të dhënat nga secila drejtori, të cilat krijojnë të ardhura për Bashkinë duke u mbështetur në Vendimin e Këshillit Bashkisë Patos nr.71 datë 30.11.2023 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024”.

Parashikimi është bërë duke ju referuar planit të vitit 2024, trendit të dy viteve parardhëse, e bazuar kjo në legjislacionet përkatëse, Të ardhurat e Bashkisë Patos për vitin 2025 - 2027 paraqiten me një rritje mesatare prej 2 % në krahasim me vitin 2024.

Këto parashikime mbështeten në llogaritjet e përgjithshme që janë të lidhura ngushtë me masat që pritet të ndërmerren nga administrata tatimore në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë, por dhe jashtë saj, për realizimin e parashikimeve të pretenduara të të ardhurave. Parashikimi i të ardhurave për këtë periudhë parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore dhe të ardhurat e tjera, duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve, por jo me ndryshime në nivelet e taksave apo tarifave.

Në këtë parashikim janë marrë në konsideratë:

- Rritja e të ardhurave nëpërmjet rritjes së bazës së taksapaguesve dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja);
- Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet;
- Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe analiza një për një e çdo takse dhe tarife.

Treguesit ekonomikë e financiarë të Bashkisë së Patos për periudhën 2022-2024, si dhe treguesit e buxhetit afatmesem 2025-2027 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Të ardhurat e Bashkisë Patos sipas tabelës së paraqitur përbëhen nga:

**Të ardhura nga burimet e veta:**

1. Të ardhurat nga taksat
2. Të ardhura nga taksat e ndara
3. Të ardhurat nga tarifat
4. Të ardhurat të tjera

**Të ardhurat nga burimet e veta vendore sipas llojit**

në 000/ lekë

	<i>BURIMET E FINANCIMIT</i>	Fakti vitit 2022	Fakti vitit 2023	I pritshmi i vitit 2024	Parashikim për vitin 2025	Parashikimi për vitin 2026	Parashikimi për vitin 2027
1	Të ardhura nga taksat vendore	58,962	59,490	90,710	90,910	91,110	91,110
2	Të ardhura nga taksat e ndara	103,635	83,958	98,834	103,834	108,834	108,834
3	Të ardhura nga tarifa	36,608	79,595	101,578	101,778	101,978	101,978
4	Të ardhura të tjera	4,108	17,155	6,310	6,310	6,310	6,310
	<b>Të ardhurat e veta totale</b>	<b>203,313</b>	<b>240,198</b>	<b>297,432</b>	<b>302,832</b>	<b>308,232</b>	<b>308,232</b>



## Të ardhurat totale Bashkia Patos për PBA 2025-2027

në/000/lekë

Emërtimi i të ardhurave Tatimore	Fakti vitit 2022	Fakti vitit 2023	I pritëshmi për vitin 2024	Parashikimi për vitin 2025	Parashikimi për vitin 2026	Parashikimi për vitin 2027
<b>Të ardhurat nga taksat</b>	<b>162,597</b>	<b>143,448</b>	<b>189,544</b>	<b>194,744</b>	<b>199,944</b>	<b>199,944</b>
Taksa mbi Ndërtesat	9,870	11,218	21,850	22,050	22,250	22,250
Taksa mbi tokën bujqësore	8,474	9,082	21,420	21,420	21,420	21,420
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	1,772	1,145	7,000	7,000	7,000	7,000
Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë për pasuri të pa luajtshme	0	27	400	400	400	400
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	17,596	18,100	17,000	19,000	21,000	21,000
Taksa e tabelës	882	635	650	650	650	650
Taksa e rentës minerare	78,114	55,638	75,434	78,434	81,434	81,434
Tatim mbi të ardhurat personale TAP	7,805	9,940	6,000	6,000	6,000	6,000
Taksa mbi truallin	37,397	37,010	38,500	38,500	38,500	38,500
Tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogël	120	253	0	0	0	0
Taksë tregu	567	400	1,290	1,290	1,290	1,290
<b>Të ardhurat nga tarifat</b>	<b>36,608</b>	<b>79,595</b>	<b>101,578</b>	<b>101,778</b>	<b>101,978</b>	<b>101,978</b>
Tarifa për pastrimin	18,720	25,252	42,031	42,231	42,431	42,431
Tarifa e shërbimit komunitar	439	1,143	5,026	5,026	5,026	5,026
Tarifë për hapsirat publike	30	30	250	250	250	250
Tarifë për ndriçim rrugor	1,240	1,505	1,800	1,800	1,800	1,800
Tarife gjelbërimi	1,384	1,393	1,800	1,800	1,800	1,800
Tarife për reklamë	0	0	507	507	507	507
Tarife për parkim	687	602	921	921	921	921
Tarifë për shërbime të tjera administrative	1,171	613	1,149	1,149	1,149	1,149
Tarife për dhënie leje liçensa dhe autorizime	1,204	1,284	3,179	3,179	3,179	3,179
<i>Tarifë ndotje mjedisi</i>	11,073	46,968	44,035	44,035	44,035	44,035
<i>Tarifa për mirmbajtje vaditje kullim</i>	660	648	880	880	880	880
Të tjera jo tatimore	0	157	0	0	0	0
<b>Të ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qera</b>	<b>2,061</b>	<b>3,509</b>	<b>3,010</b>	<b>3,010</b>	<b>3,010</b>	<b>3,010</b>
<i>Qera troje (toke)</i>	268	1,623	1,300	1,300	1,300	1,300
<i>Qera nga ndërtesat</i>	1,793	1,886	1,710	1,710	1,710	1,710
<b>Të ardhura të tjera</b>	<b>2,047</b>	<b>13,646</b>	<b>3,300</b>	<b>3,300</b>	<b>3,300</b>	<b>3,300</b>
<i>Dhurata dhe sponsorizime të ndryshme</i>	0	11,516	0	0	0	0
<i>Të ardhurat nga gjokat</i>	336	205	500	500	500	500
<i>Të ardhura nga pagesat për kopështe dhe çerdhe</i>	1,711	1,925	2,800	2,800	2,800	2,800
<b>Të Ardhurat e Veta Totale</b>	<b>203,313</b>	<b>240,198</b>	<b>297,432</b>	<b>302,832</b>	<b>308,232</b>	<b>308,232</b>

## Të ardhurat nga burimet lokale dhe burimet qendrore

në 000/lekë

	<i>BURIMET E FINANCIMIT</i>	Faktii vitit 2022	Fakti vitit 2023	Parashikimi për vitin 2024	Parashiki mi për vitin 2025	Parashikimi për vitin 2026	Parashiki mi për vitin 2027
1	<i>Të ardhura të trashguara nga viti i kaluar</i>	148,556	149,883	109,035	0	0	0
2	<i>Të ardhurat lokale</i>	203,313	240,198	297,432	302,832	308,232	308,232
3	<i>Transferata Specifike</i>	97,605	101,520	114,515	114,515	114,515	114,515
4	<i>Transferata e pakushtëzuar</i>	196,097	221,647	255,990	255,990	255,990	255,990
5	<i>Transferata Specifike të trashguara</i>	33,473	28,883	51,975	0	0	0
	<b><i>Të ardhurat gjithësej</i></b>	<b>679,044</b>	<b>742,131</b>	<b>828,947</b>	<b>673,337</b>	<b>678,737</b>	<b>678,232</b>

Drejtori të Ardhurave Vendore  
Astrit Murati

